

**«ZANI I POPULLIT» I KOSOVËS DHE METOHISË**

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

**Tetor 1942**

Me gëzim të madh kënduam numrin e parë të gazetës «Zani i popullit» që doli në Kosovë e Metohi (Kosmet). Kjo gazetë me vlerë e me lëndë të zgjedhur është trumbeta e bashkimit të popullit të Kosmetit, e bashkimit të çeliktë në Luftën Nacionalçlirimtare kundër okupatorit fashist dhe veglave të tij tradhtare të popujve shqiptar dhe jugosllavë, Merlikëve, Nediçëve dhe Drazha Mihajloviçeve<sup>1</sup> me shokë. Organi i Luftës Nacionalçlirimtare të Kosmetit është organ i vërtetë i bijve të popullit, është hallka e shëndoshë e vëllazërimit të popujve në luftë kundër armikut të përbashkët, kundër atij armiku që gjakosi dhe kërkon të skllavërojë botën, është shuplaka që i godit rëndë fytyrat e pseudonacionalistëve shqiptarë dhe jugoslla-

---

<sup>1</sup> Drazha Mihajloviç — agjent i imperializmit anglez, ministër i Luftës më 1942 në qeverinë kukull jugosllave në Londër. Bashkëpunoi me pushtuesit fashistë gjermanë kundër lëvizjes nacionalçlirimtare jugosllave, terrorizoi popullin kosovar.

vë, që kërkojnë të gjakosin popujt në interes të armikut.

«Zani i popullit» i Kosmetit është tribuna e gjallë e lëvizjes nacionalçlirimtare në Kosmet, e asaj lëvizjeje që sot organizon popullin në luftë kundër okupatorit dhe nesër do ta shpjerë popullin në liri e në pavarësi e do t'i japë të drejtat e plota popullit të Kosovës e të Metohisë që të vetëvendosë mbi fatin e tij.

Urime dhe simpati të madhe i drejtojmë nga ana jonë organit të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosmetit.

Popull shqiptar, ndihmoje sa më shumë dhe shpërndaje kudo në vatrata e vërteta shqiptare këtë organ me vlerë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 3-4, tetor 1942*

*Botohet sipas: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1. Tiranë, 1968*